



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

SONILA BUSHI

Sonila Bushi ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Provimeve të Shtetit, prej Shkurtit të vitit 2025, me fokus zhvillimin me sukses të provimeve të shtetit në profesionet e rregulluara, si dhe provimeve të digjitalizuara.

Përpara kësaj detyre, ajo ka mbajtur disa pozicione në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit, si: Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Fondit të Pyetjeve (2018 – 2025), Drejtor i komanduar i Drejtorisë gjatë vitit 2020, Specialist i Informatikës (2011 – 2018). Prej vitit 2011 vijon të mbajë rolin e Administratorit të Sistemit të Provimit të Shtetit, si dhe rolin e Administratorit të Bazës së të Dhënave të Fondeve të Pyetjeve.

Znj. Bushi ka ndjekur studimet Bachelor në programin “Kimi” dhe “Inxhinieri Elektronike me profil Informatikë”, si dhe studimet Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike. Më tej ka thelluar dhe zhvilluar dijet dhe njohuritë e saj në Administrimin dhe Menaxhimin e Bazave të të Dhënave, Sistemet e Menaxhimit të Informacionit, Inteligjencë Artificiale, Menaxhim i Projekteve, Menaxhim i Riskut Kibernetik, si dhe Etikës dhe Lidershipit në administratën publike. Zotëron shumë mirë Gjuhët Angleze, Gjermane dhe Italiane.

Znj. Bushi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm 15 vjeçar në shumë procese, që prej krijimit të Drejtorisë së Provimeve të Shtetit, duke spikatur për aftësitë e saj profesionale, teknike dhe menaxheriale.